



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Adresa: Wesley Clark p.n., 20 000 Prizren • Tel.: 029/ 244 150
e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

DATË:	29.01.2026
PËR:	Bordin e Drejtorëve Z. Ylber Elshani - Kryesues
CC	NJPMNP Znj. Vlora Tusuni
NGA:	Fadil Berisha – U.D Kryeshef Ekzekutiv
TEMA:	<i>Raport mbi vlerësimin e rrezikut, rrezikun e mashtrimit dhe rrezikun</i>

RAPORT MBI VLERËSIMIN E RREZIKUT, RREZIKUN E MASHTRIMIT DHE RREZIKUN FISKAL - Viti raportues: 2025

Hyrje dhe baza ligjore

Ky raport është përpiluar në kuadër të forcimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, transparencës dhe llogaridhënies në KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A., dhe në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe Rregulloren e MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar.

Raporti i referohet vitit 2025 dhe paraqet gjendjen e menaxhimit të rrezikut, përfshirë rrezikun e mashtrimit dhe rrezikun fiskal, si pjesë e përgjegjësisë mbikëqyrëse të Bordit të Drejtorëve ndaj Aksionarit.

Sistemi i menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm

KRU Hidroregjioni Jugor ka të vendosur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut, i ndërtuar sipas parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK). Sistemi synon identifikimin, vlerësimin, trajtimin dhe monitorimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave strategjike, operative dhe financiare të ndërmarrjes.

Vlerësimi i rrezikut dokumentohet përmes raporteve të brendshme dhe është i integruar në proceset e planifikimit vjetor, buxhetimit dhe raportimit periodik ndaj Bordit të Drejtorëve.

Vlerësimi i rreziqeve kryesore dhe masat menaxhuese

a. Rreziqet operative

Rreziqet operative janë identifikuar në fushat e furnizimit të pandërprerë me ujë, mirëmbajtjes së infrastrukturës, humbjeve teknike dhe komerciale, kapaciteteve njerëzore dhe teknike, si dhe mungesës së ujit si pasojë e thatësirave dhe uljes së nivelit të ujit në burimet furnizuese.

Gjatë vitit 2025, periudhat e zgjatura të thatësirave kanë ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e kapaciteteve ujore, duke paraqitur rrezik për furnizimin e qëndrueshëm të konsumatorëve.

Masat menaxhuese përfshijnë monitorim të vazhdueshëm të burimeve ujore, aplikim të masave për përdorim racional të ujit, planifikim operacional për periudha me rrezik të shtuar, përmes njoftimeve në platformtat elektronike, inspektimin e keqpërdorimit të ujit përmes ekipeve të inspektoratit të kompanisë, mirëmbajtje të rregullt të rrjetit për reduktimin e humbjeve teknike, si dhe raportim periodik ndaj menaxhmentit dhe Bordit të Drejtorëve.

b. Rreziqet financiare

Rreziqet financiare lidhen me arkëtimin e të hyrave, menaxhimin e likuiditetit, shpenzimet operative dhe investuese, si dhe menaxhimin e obligimeve financiare.

Gjatë vitit 2025, sfidë e veçantë në kuadër të shpenzimeve operative kanë qenë shpenzimet e energjisë elektrike, të cilat janë rritur dukshëm, si pasojë e daljes së ndërmarrjes në tregun e lirë të energjisë. Luhatjet e çmimeve dhe pasiguria në furnizim kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve operative.

Masat menaxhuese përfshijnë monitorim të vazhdueshëm të shpenzimeve të energjisë, përfshirje të këtij rreziku në planifikimin buxhetor, monitorim të shpenzimeve tjera si ato të mirëmbajtjes së rrjetit dhe mirëmbajtjes së veturave, përmes blerjes së makinerisë së re dhe forcim të kontrollit të brendshëm financiar.

c. Rreziku i mashtrimit

Rreziku i mashtrimit trajtohet përmes zbatimit të Kodit të Etikës, ndarjes së funksioneve kyçe, procedurave të brendshme dhe auditimeve të rregullta të brendshme.

Gjatë vitit 2025 nuk janë identifikuar raste të konfirmuara të mashtrimit, megjithatë fushat me rrezik të shtuar janë objekt i monitorimit të vazhdueshëm dhe përfshihen në planet e auditimit të brendshëm.

d. Rreziku fiskal

Rreziku fiskal lidhet me qëndrueshmërinë financiare, rrjedhën e mjeteve financiare dhe nivelin e arkëtimeve. Gjatë vitit 2025, qëndrueshmëria financiare e KRU Hidroregjioni Jugor ka qenë e mirë.

Megjithatë, është identifikuar rrezik fiskal që buron nga mos pagesa ose vonesat në pagesa të të arkëtueshmeve nga disa institucione publike, konkretisht nga shkollat, spitali, Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Malishevës, si dhe nga ekzistenca e borxheve të vjetra të amvisërisë

Gjithashtu, rrezik tjetër gjatë vitit 2025 janë edhe ndëshkimet dhe obligimet financiare të shqiptuara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), si rezultat i kontrolleve tatimore për periudhat **2020–2024**, të cilat kanë krijuar ngarkesë shtesë financiare dhe kanë ndikuar negativisht në rrjedhën e mjeteve financiare, veçanërisht në planifikimin buxhetor për vitin **2026**.

Po ashtu, rrezik fiskal mund të paraqesin edhe **paditë e mundshme gjyqësore nga palë të jashtme ndaj KRU Hidroregjioni Jugor**, të cilat, në rast të vendimeve të pafavorshme, mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen financiare, shpenzimet e paplanifikuara dhe qëndrueshmërinë fiskale të ndërmarrjes.

Masat menaxhuese të ndërmarra dhe/ose të planifikuara:

- ndjekje sistematike e të arkëtueshmeve institucionale;
- komunikim dhe koordinim i vazhdueshëm me institucionet dhe konsumatorët debitorë;
- planifikim dhe përfshirje të obligimeve tatimore në buxhetin afatmesëm;
- ndjekje dhe menaxhim aktiv të obligimeve ndaj ATK-së;
- bashkëpunim me këshilltarë ligjorë për menaxhimin e rasteve gjyqësore;
- krijim të rezervave financiare për rreziqe të mundshme ligjore dhe fiskale;
- raportim periodik ndaj menaxhmentit dhe Bordit të Drejtorëve lidhur me ndikimin fiskal të këtyre rreziqeve.

Auditimi i brendshëm dhe masat korigjuese

Gjatë vitit 2025 janë realizuar auditime të brendshme të rregullta, si dhe auditime specifike sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv. Auditimet kanë adresuar proceset financiare, operative dhe të pajtueshmërisë.

Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit janë trajtuar përmes planeve të veprimit dhe masave korigjuese të dokumentuara, ndërsa zbatimi i tyre është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme.

REGIONAL
JUGOR
KRE
KRYE

Integrimi i rrezikut në qeverisje dhe planifikim

Vlerësimi i rrezikut është i integruar në proceset e planifikimit vjetor, buxhetimit dhe raportimit periodik tremujor, të cilat miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Përfundim

Raporti për vitin 2025 dëshmon se KRU Hidroregjioni Jugor ka mekanizma funksionale të kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut, duke kontribuar në transparencë, parandalim të mashtrimit dhe përgjegjshmëri financiare.

Shtojcë: Tabela e Vlerësimit të Rrezikut

Nr.	Lloji i Rrezikut	Përshkrimi	Ndikimi	Masat Menaxhuese	Statusi
1	Operativ	Thatësirat dhe mungesa e ujit Kualiteti i ujit	I Lartë	Monitorim burimesh, Kualitetit menaxhim racional, reduktim humbjesh	Në monitorim
2	Financiar	Rritja e kostos së energjisë elektrike	I Mesëm	Planifikim buxhetor, eficiencë energjetike	Në trajtim
3	Mashtrim	Keqpërdorim i proceseve financiare	I Ulët	Auditim i brendshëm, ndarje funksionesh	Në monitorim
4	Fiskal	Mos pagesa nga institucionet publike, ndëshkimet nga ATK	I Mesëm	Ndjekje arkëtimesh, koordinim institucional	Në monitorim



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidroregjioni Jugor" SH.A me seli në Prizren, bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, Kodin e Etikës dhe Qeverisjen Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe Rregulloren e MF NR.01/2019 për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet me plotësim ndryshimet e propozuara Raporti mbi vlerësimin e rrezikut, rrezikun e mashtrimit dhe rrezikun fiskal për vitin raportues 2025.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të Raportit mbi vlerësimin e rrezikut, rrezikun e mashtrimit dhe rrezikun fiskal për vitin raportues 2025, Bordi i Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidroregjioni Jugor" SH.A bëri plotësim ndryshime të këtij Raporti, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren

Ylber Elshani

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

